



Datë: 16.06.2025

Numër Protokolli: 4143/2025

A.nr.679/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.679/2025, të datës 17.04.2025, të parashtruar nga ankuesi B.V, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 16.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.679/2025 e datës 17.04.2025, e parashtruar nga ankuesi, B.V.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.V (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) më datë 17.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2571/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.679/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shpalljes së Konkursit me numër Reference RN00016383, të datës 20.01.2025, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Mitrovicë*”, nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 17.04.2025 **është e palejuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës ka gjetur se Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, më datë 20.01.2025, ka shpallur Konkursin me numër reference RN00016383 për pozitën e punës “Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Mitrovicë”, me afat aplikimi nga data 21.01.2025 deri më datë 19.02.2025, në të cilin konkurs kishin aplikuar gjithsejtë 13 kandidatë, ndërsa sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi nuk kishte aplikuar.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon pezullimin apo anulimin e konkursit përkatës, mbi pretendimet ankimore se i njëjti është kandidat i pakontestueshëm për ushtrimin e kësaj pozite, pasi që nga organi i punësimit i cili ka iniciuar shpalljen e kësaj procedure rekrutimi është degraduar në pozitë, dhe se në Zyrën Regjionale në Mitrovicë është paraparë vetëm një pozitë e nivelit drejtues, dhe se për këtë arsye i njëjti thekson se nuk është dashur të inicohej procedura e rekrutimit në fjalë.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se : Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative;*, si dhe nenit 124 paragrafi 1 i të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim;*, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me rastin e shpalljes së Konkursit me numër reference RN00016383 për pozitën e punës “Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Mitrovicë”, ankuesit nuk i ka cenuar ndonjë të drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e tij të punës, andaj i njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.679/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.679/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.V;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.